

Dokumenti konsultues që përmban afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese dhe adresën për pranimin e komenteve për Projekt- Strategjisë Komunale për Informim dhe Komunikim 2022-2025

Strategjisë Komunale për Informim dhe Komunikim 2022-2025 gjendet në diskutim publik nga data 28.01.2022 deri me 28.02.2022

Kjo Strategjisë Komunale për Informim dhe Komunikim 2022-2025, janë të shënuar të dhëna që kanë të bëjnë me profilin e komunës, administratën komunale, kornizën ligjore, perceptimet e qytetarëve, websajti i komunës dhe platformat sociale, transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, marrëdhëniet me mediat, komunikimi i brendshëm, promovimi dhe marketingu i komunës, vlerësimi vetanak, avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunal, krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat dhe rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Administrata komunale

Administrata komunale në Rahovec është e organizuar në 12 drejtori: Drejtoria për Administratë e Përgjithshme, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Shërbime Publike Komunale, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Punët Inspektuese, dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Në kuadër të administratës, më saktësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: Zyra e Avokatit të Komunës, Zyra për Integritet Evropian, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra Ligjore, Zyra për Auditim të Brendshëm, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyra e Prokurimit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Barazi Gjinore, Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut, dhe Zyra për Lektorim.

Misioni i Komunës

Komuna e Rahovecit synon të krijojë qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike, performancë, transparençë dhe llogaridhënie, përmes të cilave do të arrijë një qeverisje të cilësisë së lartë në shërbimin e nevojave të qytetarëve dhe për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët.

Korniza ligjore

Hartimi i kësaj Strategjie është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparençën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë

Komuna vazhdon të kultivojë një bashkëpunim të shëndoshë me organizatat e shoqërisë civile. Për këtë arsye janë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale si dhe për krijimin e hapësirave për monitorimin e performancës së institucioneve komunale. Organizata joqeveritare vendore kanë një trajtim të veçantë kur është fjala për pjesëmarrjen e tyre në ngjarjet komunale, hartimin e politikave dhe pasurimin e legjislacionit, apo çështjeve të tjera me interes publik. Për më tepër, OJQ-të vendore janë të përfshira në organizimin e shumë ngjarjeve publike që kanë për qëllim rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit me organet shtetërore, përfaqësive diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare me synimin e bashkërendimit të veprimeve në funksion të ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme të komunës në sferën e qeverisjes së mirë, mirëqenies së qytetarëve, por edhe në avancimin e infrastrukturës komunale përmes projekteve kapitale. Komuna edhe në të ardhmen do të vazhdojë të kultivojë marrëdhënie të shëndosha me aktorët e këtij niveli në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e madhe për projektet dhe nismat që tejkalojnë kapacitetet vetanake të komunës.

Promovimi dhe marketingu i Komunës

Në një stad zhvillimi që ka arritur sot, komuna ka nevojë që të rrisë ndjeshëm nivelin e promovimit dhe marketingut të aseteve dhe pasurive të trashëgimisë kulturore, historike, turistike apo ekonomike. Komuna duhet të hulumtojë për forma kreative dhe ekonomikisht të përballueshme në promovimin e vlerave të saj, qoftë në formë të printuar apo digjitale.

Zhvillimi i njësive të standardizuara të identitetit vizual të Komunës (slogani, flamuri, raportet, broshurat, publikimet, prezantimet PPT, fletoret, lapsat, plaketat e komunës, etj.) dhe realizimi i videove promovuese për destinacionet atraktive për vizitorë (Teqja e Madhe-Helvetive, Teqja Rufai; Teqja Melami; Sahat Kulla dhe Vreshtat e Rahovecit) janë disa nga hapat që duhet konsideruar në nisje, dhe e gjithë kjo do të duhej të kulminonte me hartimin e një strategjie të konsoliduar për promovimin dhe marketingun e komunës.

Zbatimi i strategjisë do të bëhet nga të gjitha drejtoritë komunale dhe zyrtarët e zyrës së kryetarit të Komunës.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën 28.02.2022 në ora 16:00, tek zyrtarët:

Saranda.Sallteku@rks-gov.net; Haziz.Krasniqi@rks-gov.net; Skender.Hamza@rks-gov.net dhe Blerta.Gashi@rks-gov.net.